



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 336/1 Prishtinë 09.02.2023

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Getuar Krasniqi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Analiza e shfrytëzimit hidroenergjetic për Lumbardhin e Deçanit (II)** ” në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

### ABSTRAKT

Kur flasim për energjinë, llojet dhe burimet e saj, nuk mund të anashkalojmë burimet e ripërtërishme, si burime gjithnjë në rritje për prodhimin e energjisë elektrike në shumicën e vendeve të botës. Shumica e energjisë elektrike të konsumuar sot në botë prodhohet nga lëndët djegëse fosile, të cilat janë të lehta për tu eksploruar e të lira për tu përdorur, por njëkohësisht të dëmshme dhe aspak miqësore me ambientin. E kur flasim për burimet e ripërtërishme, si njëra ndër kryesoret nga to, si nga kapacitetet e instaluar po ashtu edhe të planifikuara, është energjia që vije nga burimet ujore apo Hidroenergja.

Energjia e cila prodhohet nga burimet ujore bazohet në prodhimin e energjisë, qoftë asaj elektrike apo formave të tjera të saj, duke shfrytëzuar energjinë potenciale të rënies së ujërave nga lartësia dhe energjinë kinetike të lëvizjes së tyre. Historikisht, energjia e burimeve ujore është shfrytëzuar si potencial për prodhimin e energjisë mekanike të rrotullimit, ku pastaj kjo energji është shfrytëzuar për nevoja të ndryshme njerëzore, siç janë bluarja e drithërave, pastrimi i rrobave, etj. Më vonë në fund të shekullit të XVIII, filloj shfrytëzimi i potencialit të burimeve ujore për prodhimin e energjisë elektrike.

Në këtë studim, është paraqitur analiza e shfrytëzimit hidroenergjetic, duke përfshirë potencialin e prodhimit të energjisë, fuqisë instaluese, krahasimit në mes të fuqisë së llogaritur dhe asaj të instaluar dhe konkluzione të tjera lidhur me hidrocentralin Lumbardh II. Analizat janë realizuar duke marrë parasysh të dhënat e prurjes së ujit nëpër lumin Lumbardh për vitet 1952-1986, të dhënat meteorologjike, siç janë reshjet ndër vite, temperaturat mesatare, shpejtësia e erës, shtypja atmosferike, etj. Në studim janë përfshirë analiza teorike dhe analitike të rastit në fjalë, duke përdorur kalkulimet dhe paraqitur grafikisht të dhënat e lartcekura.

Nga studimi i realizuar rezultoi se, vlera e kalkuluar e diametrit optimal të tunelit të betonit është 1.6 metra dhe vlera e kalkuluar e diametrit optimal të gypsjellësit të çelikut është 1.7 metra. Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga ky hidrocentral është afërsisht 68 GWh. Prurja instaluese e hidrocentralit është 4.64 m<sup>3</sup>/s. Pas leximit nga diagrami, në bazë të të dhënave të lartcekura, janë zgjedhur dy turbina të tipit Francis, me fuqi të instaluar prej Q = 4250 kW.

Fjalë kyçe: Gypsjellës, tunel, hidrocentral, lumë, akumulacion, rezervuar, vepër e marrjes, turbinë, analizë hidrologjike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.